



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN200620240009

Tiranë, më 11.10.2024

Komisioni 131

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi Juridik: “IKERAL” Sh.p.k.
Nr. NIPT-i: J64103811M
Adresa e selisë: Krekëz pranë fshatit Nivicë, Lukovë.
Personi përgjegjës: Filippos Sapounas

Për të zhvilluar projektin “**Instalimet me djegie.**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Instalimet me djegie.

Vendndodhja: Sarandë, Nivicë, Krekëz.

Të dhëna teknike:

Energjia termike në hyrje është e barabartë ose më e madhe se 50 MW.
Furrat kanë gjatësi 120 metra, gjerësi 4.6 metra dhe lartësi 2.3 metra.
Kapaciteti maksimal 45 vagona, temperaturë e pjekjes arrin deri në 980°C

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë teknike të ministries shprehin mendimin si më poshtë vijon:

• Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e cilësisë së ajrit në mjedis, sugjerohet që gjatë fazës së funksionimit të instalimit me djezie duke përdorur burimet alternative, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr.435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;

- Të bëhet monitorim periodik i kushteve teknike të instalimit, sistemi i filtrimit, dhe të sistemi i filtrave garantohet mbajtja nën kontroll e parametrave, për të parandaluar dhe shmangur, emetimin e ndotësve të gaztë mbi normat e lejuara, dhe minimizuar shkarkimet dhe grimcave të pluhurave;

- Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr.412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;

- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr.412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

Gjithashtu gjatë funksionimit të aktivitetit duhet të bëhet monitorim periodik i cilësisë së ajrit.

• Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e menaxhimit të kimikateve, sugjerohet që gjatë fazës së funksionimit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr.488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe VKM-së nr.9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”);

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.

• Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” rekomandohet të:

-“impantet të pajisen me teknologji të avancuar për filtrimin e emëtimeve”;

Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike;

- që të kryhet gjerlbërimi i hapësiravë përreth objektit ku ushtrohen aktivitetet;

Lidhur me bazën ligjore të cituar në raportin e VNM-së, shprehem si më poshtë vijon:

Vihet re se në këtë raport nuk është cituar ligji aktual në fuqi nr.62/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar;

Vihet re se në këtë raport nuk është cituar ligji aktual në fuqi nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;

Vihet re se në këtë raport nuk është cituar as ligji në fuqi nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike;

• Të dy sektorët si i pyjeve ashtu edhe sektori i mbrojtjes së natyrës për këtë aktivitet shprehen se nuk kanë komente sugjeruese.

• Të zbatohet Ligji nr.10463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

• Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

• Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

• Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.

• Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.

• Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr.10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

• Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

• Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr.418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Gjithashtu, theksojmë se dokumenti “përmbledhje e konsultimeve me publikun” nuk është realizuar në përmbushje të përcaktimeve ligjore në fuqi. Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr.10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “Instalimet me djegie”, Fshati Nivicë, Lukovë, Sarandë, me zhvillues “IKERAL” dhe aplikues “STUDIOPROJEKT” me nr. Aplikimi AN200620240009, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shprehet: Në përgjigje të kërkesës suaj mbi aplikimin për VNM e thelluar për Deklaratë Mjedisore e subjektit “Studioprojekt” sh.p.k, me zhvillues subjektin “IKERAL” sh.p.k në lidhje me projektin: “Instalimet me djegie”, me të dhënat:

Nr. AN200620240009, të datës 20.06.2024, kërkesat e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, të cilat duhet të merren parasysh dhe të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së janë si më poshtë vijon:

1. Të jepet një përshkrim i ndikimeve negative të rëndësishme të projektit të propozuar në cilësinë e ujërave apo ndikime negative shtesë (kumulative) në burimet ujore në rastet e reshjeve atmosferike;
2. Pas mbarimit të procedurës së VNM-së, subjekti “IKERAL” sh.p.k të aplikojë në portalin on-line të e-albania “Aplikim për përdorim burimi uJOR” për t’u pajisur me leje/autorizim për shkarkimin e ujërave të përdorur, bazuar në ligjin Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të ndryshuar si dhe VKM-së nr. 550, datë 15.7.2020, pasi ka një listë të gjatë të lëndëve të para (mbetje) të cilat nën efektin e reshjeve atmosferike mund të shkaktojnë ndotje të ujërave nëntokësore apo dhe sipërfaqësore në zonë;
3. Në programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit të përfshihet dhe monitorimi i ujërave pritëse, si dhe të përcaktohet vlera kufi e emetimit për secilin nga ndotësit/substancat e rrezikshme të identifikuara, që mund të shkarkohen në trupat uJORë gjatë zhvillimit të aktivitetit, të shprehura në termat e parametrave specifike të sigurt, përqendrimit ose nivelit të emetimit, që nuk duhet të tejkalohet gjatë një ose më shumë periudhave kohore

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet Verifikimi në objekt për inspektimin e subjektit nga specialistët e Lejeve dhe VNM-ve për dhënien e mendimit për VNM u mbështet në Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjin Nr.10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Vendimin numër 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe akteve nënligjore mjedisore në fuqi, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastër ngriti grupin e punës më datë 06.09.2024 të përbërë nga Specialistët e Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve Z. Jani Vasili dhe Z. Iliden Maze për “IKERAL” Sh.p.k me aktivitet “Instalimet me djegie” dhe vendndodhje, Lukovë, fshati Nivicë, Krekez, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.

Aktiviteti zhvillohet në fabrikaën e prodhimit të tullave me vendndodhje fshati Nivicë, në krahun e djathtë të rrugës nacionale Sarandë – Lukovë- Vlorë, Km 10. Distanca nga fshati Nivicë është rreth 2.5 km në vijë ajrore dhe distanca nga fshati Vanë është rreth 3 km në vijë ajrore. Nga veriu, në afërsi të zonës së projektit ndodhen 2-3 shtëpi banimi në distancë rreth 100 m në vijë ajrore. Aktiviteti zhvillohet në fabrikaën e prodhimit të tullave me vendndodhje fshati Nivicë, në krahun e djathtë të rrugës nacionale Sarandë – Lukovë- Vlorë, Km 10. Distanca nga fshati Nivicë është rreth 2.5 km në vijë ajrore dhe distanca nga fshati Vanë është rreth 3 km në vijë ajrore. Nga veriu, në afërsi të zonës së projektit ndodhen 2-3 shtëpi banimi në distancë rreth 100 m në vijë ajrore. Objekti shtrihet në sipërfaqe të rrafshët e cila aktualisht është e shtruar me beton dhe e rrethuar me murr. Në brendësi të objektit gjenden mjetet e punës dhe në dyshtet e objektit gjenden gropa në funksion të makinerive dhe proceseve teknologjike. Infrastruktura është e ngritur, inplanti i instalimit me djegie ndodhet brënda sipërfaqes së fabrikes së tullave.

Fabrika e tullave është ekzistuese dhe ushtron aktivitetin para viteve 1990 në këtë zonë. Aksesit për në objekt, kryhet fillimisht nëpërmjet aksit rrugor Sarandë - Lulovë dhe më pas në rrugën dytësore rurale Krekëz. Burimi uJOR më i afërt me zonën e projektit është Gjiri i Kakomesë (Deti Jon) në një distancë rreth 4 km në vijë ajrore nga zhvillimi i projektit. Në vendndodhje të projektit nuk ka bimësi. Përrreth zonës së projektit paraqiten vlera tipike mesdhetare bregdetare. Bimësia në këtë zonë është e përbërë prej shkurresh të moderuara dhe pemë halore dhe frutore si dhe Ullishte te vjetra.

Sugjerime: • Mbetjet inerte të ripërdoren kur është e mundur ose të largohen rregullisht nga sheshi i ndërtimit duke u depozituar në pikat e caktuara nga Bashkia Himaë si dhe të trajtohen sipas

kërkesave të VKM Nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

- Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujqor dhe atë tokësor.
- Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedisin tokë do të duhet të ruhet vegjetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim.
- Të kryhet rrethimi i kantierit të ndërtimit gjatë punimeve dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Gjatë transportit të përdoren mushamatë e kamionave për të shmangur përhapjen e dherave e të materialeve inerteve në rrugët lidhëse të zonës.
- Të merren masa për të zvogëluar ose zbutur efektet e zhurmës dhe dridhjeve aty ku ato janë praktike dhe me kosto efektive.
 - Të merren masat për lagjen e rrugëve të aksesit në kantier të cilat do të përdoren nga mjetet e tonazhit të lartë duke ulur mundësinë e përhapjes së grimcave të ngurta në mjedis.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
 - Të bëhet sistemimi, rehabilitimi i sheshit të ndërtimit dhe të krijohen sipërfaqe të gjelbërta rreth objektit pasi ky i fundit të ketë përfunduar procesin ndërtimor sipas Lejes Zhvillimore.
- Në rast se do të kemi dëmtim të habitateve të merren masa për rehabilitimin e tij ose zëvendësimin me habitat të ri.
- Të merren masa për zbutjen e ndikimit në peizazh duke ruajtur natyralitetin e zonës.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: U krye në datë 20.09.2024. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga NJQV kryetar i fshatit, Agjencia Rajonale e Mjedisit si dhe Eksperti i Mjedisit (i autorizuari), dhe i autorizuari i Administratorit. Në zbatim të Vendimit nr.247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore” të ndryshuar. Në konsultim me publikun nuk ka patur ankesa dhe pakënaqesi të shprehura nga banorët.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 131, datë 11.10.2024, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.82, datë 02.05.2024, nr.4934 prot, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
- Subjekti “Ikeral” sh.p.k është i pajisur me Leje Mjedisore Tipi A, me PN-7007-03-2014, për aktivitetin “Prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit.”, me vendndodhje Lukovë, Sarandë, Vlorë.
 - Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
 - Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.
 - Mendimin e banorëve në Degjesën me Publikun.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- 4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.4 **Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.** Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.
- 4.5 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të veçantë.

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.7 Të instalohet sistemi i eleminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në ARM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 **Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.20 Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.

- 4.21** Personi përgjegjes teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.
- 4.22** Mbetjet që gjenerohen nga procesi i punimeve të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
- 4.23** Të bëhet kontrolli i kushteve teknike në mënyre periodike të mjeteve të punës, për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e ndotësve në gaz të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- 4.24** Të merren masa të sigurimit teknik që punimet të mos kryhen në oraret e papërshtatme dhe mbi normat e lejuara të zhurmave, si dhe të zbatohet Udhëzimi nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, i ndryshuar.
- 4.25** Të përdoren automjete të mbuluara (të mbyllura ose të mbuluara me mbulesë të posaçme) për transportin e materialeve të thata.
- 4.26** Pastrimi i bimësisë të jetë i kufizuar vetem brenda kufijve ku do të zhvillohet projekti.
- 4.27** Pas përfundimit të fazës së punimeve, sugjerojmë rehabilitimin e plotë të sipërfaqeve të lira dhe krijimin e sipërfaqeve të gjelbërta, përreth objektit.
- 4.28** Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.29** Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.30** Subjekti të marrë masa për rehabilitim e sipërfaqes së shfrytëzuar nese ka.
- 4.31** Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.32** Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.33** Të zbatohet me rigorozitet rregullorja e vendit të punës.
- 4.34** Të lejohet hyrja vetëm e personave që kanë kualifikim për të administruar mbetjet.
- 4.35** Të tregohet kujdes për sigurinë e kontenierëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era
- 4.36** Të jenë ndërtuar me material të qëndrueshme që pastrohen lehtësisht, që nuk lejojnë depërtimin e lëngjeve dhe të jenë rezistente ndaj parazitëve.
- 4.37** Gjatë zhvillimit të aktivitetit të trajtimit të mbetjeve të merren masa mbrojtëse kundër aromave të pakëndshme duke instaluar sistemin e ventilimi-filtrimit për eliminimin e tyre.
- 4.38** Të instalohet oxhaku, lartësia e të cilit të kalojë patjetër lartësinë e objekteve me te aferta me te.
- 4.39** Të vendosen filtrat në oxhak, të cilët të ndërrohen periodikisht ne varesi te kapacitetit te trajtimit te mbetjeve.
- 4.40** Të merren masa për sigurimin teknik në ambjentet e kompanisë, të bëhet sistemimi ajrosja e ventilimi i ambjentit.
- 4.41** Trajtimi i mbetjeve në impiant të bëhet në një kohe sa më të shkurtër të mundshme duke ulur kohën e ekspozimit të tyre ndaj agjentëve të mjedisit;
- 4.42** Subjekti të mbajë rregjistër për sasin e mbetjeve të trajtuara dhe të raportojë të dhënat cdo 6 muaj pranë ARM-së të qarkut përkatës.
- 4.43** Shkarkimet ne mjedis të jenë nën vlerat e lejuara sipas VKM Nr. 435, date 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër”.
- 4.44** Perpara fillimit te aktivitetit, subjekti te kete te hartuar planin e monitorimit dhe të raportimit dhe ta dorëzoi pranë ARM-së dhe AKM-së.
- 4.45** Mbetjet e trajtuara, hiri të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 4.46** Subjekti duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura të raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

4.47 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

4.48 Ndalohet përdorimi i mbetjeve të rrezikshme/ shpërthyes/helmuese si lëndë e parë për djegie.

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	11.04.2025	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	11.04.2025	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	11.04.2025	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	11.04.2025	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	11.04.2025	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
---------	-------------	------------------	---------------

Lëndët në pezulli	50 mg/l	11.04.2025	Çdo 6 muaj
-------------------	---------	------------	------------

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve.
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
 - Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
 - Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI


MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Konfirmoi:

Pranoi:

Aneksi I. Harta me Koordinatat



Nr.	X	Y
1.	4422255.73	4413344.59
2.	4422335.58	4413308.91
3.	4422358.45	4413347.00
4.	4422404.95	4413492.28
5.	4422332.35	4413701.73
6.	4422301.51	4413697.88
7.	4422217.83	4413574.24

Sipërfaqja totale është 25000 m².

Aneksi II: Shtojca II e ID që kërkohen të shtohen në aktivitet.

02 01 02	Mbetje nga indet e kafshëve
02 01 03	Mbetje të indeve bimore
02 01 04	Mbetje të lëndëve plastike (me përjashtim të ambalazheve)
02 01 07	Mbetje që vijnë nga pylltaria (silvikultura)
02 01 09	Mbetje bujqësore, përveç atyre të paraqitura në rubrikën 02 01 08
02 02 02	Mbetje që vijnë nga indet shtazore
02 03 04	Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim
0205 01	Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim
02 07 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
05 01 10	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 05 01 09
05 01 17	Përzierje bituminoze
10 03 18	Mbetje nga prodhimi i anodave që përmbajnë karbon, të tjera nga ato të përmendura në 10 03 17
15 01 03	Mbetje ambalazhi druri
15 01 05	Mbetje ambalazhi të përbëra
15 01 06	Mbetje ambalazhi
15 01 09	Mbetje ambalazhi tekstili
15 02 03	Absorbente, materiale filtrues, copa rroba thithëse, të tjera nga ato të përmendura në 15 02 02
16 01 03	Goma jashtë përdorimit
16 01 19	Plastika
17 02 01	Dru
17 02 03	Plastikë
17 03 02	Përzierje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01
19 02 03	Mbetje të përziera paraprakisht, të kompozuar vetëm nga mbetje të parrezikshme
19 05 01	Fraksione të pakompostuara të mbetjeve urbane dhe mbetjeve të tjera të ngjashme
19 05 02	Fraksione të pakompostuara të mbetjeve bimore dhe shtazore
19 05 03	Kompost jashtë specifikimit
19 05 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
19 12 10	Mbetjet e djegshme (skarcitetet e lëndëve djegëse)
19 12 01	Letër e karton
19 12 04	Plastik gomë
19 12 07	Drurë të tjerë nga ato të përmendura në 19 12 06
19 12 08	Tekstilet
19 12 10	Mbetjet e djegshme (skarcitetet e lëndëve djegëse)
19 12 12	Mbetje të tjera (përfshirë material të përziera) nga trajtimi mekanik i mbetjeve, të tjera nga ato të përmendura në 19 12 11
20 01 01	Letër dhe karton
20 01 39	Plastikët
05 01	Mbetje që vijnë nga rafinimi i naftës
05 01 10	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 05 01 09
05 01 13	Llumra të dala nga trajtimi i ujit ushqyes të kaldajave
05 01 14	Mbetjet që vijnë nga kolonat e ftohjes
05 01 16	Mbetjet që përmbajnë sqfur të dala nga procesi i desulfurimit të naftës
05 01 17	Përzierje bituminoze
05 01 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
05 06	Mbetjet e dala nga trajtimi pirolitik i qymyreve
05 06 04	Mbetje të dala nga kolonat e ftohjes
05 06 99	Mbeturina të tjera të paspecifikuara
05 07	Mbetje të dala nga pastrimi dhe transporti i gazit natyror